



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 89**

**27 maj**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr. 411, datë 15.5.2013	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a., për pagimin e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).....	3755
Udhëzim i MF nr. 8/1, datë 17.5.2013	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.....	3764
Vendim i GJK nr. 22, datë 20.5.2013	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr.677, datë 5.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.400, datë 23.2.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).....	3767
Vendim i GJK nr. 23, datë 22.5.2013	Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 25.8.2010 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kalaja e Dodës, z. Bajram Himallari”. .....	3776
Vendim i ERE nr. 44, datë 30.4.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për Hec “Smokthina” të shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie .....	3778
Vendim i ERE nr. 45, datë 30.4.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet: “ARRAS”, “FUNARES”, “DUKAGJIN”, “NIKOLICE”, “BULQIZE”, “LURE”, “ORGJOST”, “LEKBIBAJ”, “VELCAN”, “ZERQAN”, “BORSH”, “LESHNICE”, “SHOSHAN”, “UJANIK”, “KERPICE”, “BARMASH”, “LUNIK”, “HOMESH”, “MUHUR”, “RAJAN”, “MARJAN” dhe “TRESKE 2” të shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. si burime të rinovueshme energjie.....	3778

Vendim i ERE nr. 46, datë 30.4.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Vithkuq” të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. si burim i rinovueshëm energjie.....	3779
Vendim i ERE nr. 47, datë 3.5.2012	Mbi projektet prioritare në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2013..	3780
Vendim i ERE nr. 48, datë 3.5.2013	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Energy Partners-Al” sh.p.k. me nr. 118, serie pv11k, lëshuar me vendim të bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2011.....	3781
Vendim i ERE nr. 49, datë 3.5.2013	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. me nr. 30, serie PV06P, lëshuar me vendim të bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 11.1.2006 .....	3782
Vendim i ERE nr. 50, datë 3.5.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “En.Ku” sh.p.k. me nr. 10, seria PV03P, lëshuar me vendim të bordit të komisionerëve të Ere-s nr. 20, datë 19.1.2003, modifikuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008 .....	3783
Vendim i ERE nr. 51, datë 3.5.2013	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit dhe tregimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a.....	3784
Vendim i ERE nr. 52, datë 3.5.2013	Për licencimin e shoqërisë “Tucep” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Tucep”.....	3784
Vendim i ERE nr. 53, datë 3.5.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Emikel 2003” sh.p.k.....	3785
Vendim i ERE nr. 54, datë 3.5.2013	Për shtyrjen e afatit të vendimit nr. 161, datë 7.12.2012 të bordit të komisionerëve të ERE-s.....	3786

**VENDIM**  
**Nr. 411, datë 15.5.2013**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE,  
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS E DREJTORISË SË  
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË  
“KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR PAGIMIN E RIMBURSIMIT TË TATIMIT MBI  
VLERËN E SHTUAR (TVSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., të kontratës për shitjen e të gjithë kapitalit të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. (shtojca 7, pjesa 1, pika 14)”, ratifikuar me ligjin nr. 94/2013, datë 4.3.2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a.”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a., për pagimin e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe shoqëria “Kurum International” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**MARRËVESHJE**

**PËR PAGIMIN E RIMBURSIMIT TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH) NDËRMJET  
MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MINISTRISË SË EKONOMISË,  
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DREJTORISË SË  
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE “KURUM  
INTERNATIONAL” SHA**

**10.5.2013**

Kjo marrëveshje lidhet në Tiranë, Shqipëri, sot më 10.5.2013 ndërmjet:

Nga njëra anë: 1. Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri, z. Ridvan Bode (në vijim MF); 2. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministri z. Florjon Mima (në vijim METE); 3. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Gazmir Spahija (në vijim DPT);

dhe nga ana tjetër, “Kurum International” sh.a., një shoqëri aksionare, e themeluar dhe e cila vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në komunën Bradashesh, Kombinati Metalurgjik, Elbasan, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër unik identifikimi K02727230T, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj ligjor z. Koray Zeytinoglu, mbajtës i kartës shqiptare të identitetit me numër 027808919;



Secila nga MF-ja, METE dhe DPT-ja do të quhen bashkërisht “autoritetet shtetërore” dhe secila nga MF-ja, METE, DPT-ja dhe “Kurum”-i do të quhen në vijim veçmas si pala dhe bashkërisht si palët.

Duke marrë në konsideratë se:

a) Në bazë të kërkesës së “Kurum”-it, organet tatimore shqiptare kanë kryer verifikimin për të konfirmuar TVSH-në e papaguar të rimbursueshme të “Kurum”-it. Shuma finale e TVSH-së së rimbursueshme të “Kurum”-it është konfirmuar në bazë të raport-kontrolleve: nr. 12775/10 prot., datë 2.12.2011, - nr. 89/9 prot., datë 4.4.2013, - nr. 11602/52 prot., datë 8.4.2013, - nr. 5005/4 prot., datë 16.4.2013, - nr. 8164/1 prot., datë 9.5.2013, dhe vendimit të Drejtorisë së Apelitit Tatimor: 89/9 dhe 11602/52;

b) “Kurum”-i është shpallur ofertuesi fitues i procedurave të tenderimit për privatizimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., e cila është një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli në: Dibër Burrel, Ulëz-Burrel, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me numër unik identifikimi L183069010, e zotëruar tërësisht nga Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE);

c) Oferta e “Kurum”-it për privatizimin e 100% të aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. kërkonte se shumata që shteti shqiptar i detyrohet ofertuesit, në formën e rimbursimit të TVSH-së të verifikuar, të njihen nga autoriteti kontraktor (METE) dhe të përfshihen në negociatat kontraktore;

d) Në bazë të kësaj kërkesë, marrëveshja e shitblerjes së aksioneve, e lidhur ndërmjet “Kurum”-it dhe METE-s për shitblerjen e 100% të aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. (në vijim MSHA e Ulëz-Shkopet), përfshin, ndër të tjera, si kusht paraprak, lidhjen e një marrëveshjeje me shkrim mes Ministrisë së Financave të Shqipërisë (apo organeve të tjera kompetente tatimore) dhe blerësit (Kurum), për skedulimin e pagesës së shumave që shteti shqiptar i detyrohet blerësit, në formën e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) të verifikuar sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar;

e) Gjithashtu, përveç MSHA të Ulëz-Shkopet, “Kurum”-i dhe METE kanë lidhur një marrëveshje për shitblerjen e 100% të aksioneve të “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. (në vijim MSHA e Bistricës), e cila nuk kushtëzohet nga rimbursimi i TVSH-së në favor të “Kurum”-it;

f) Gjatë realizimit të procesit të verifikimit të tepricës së TVSH-së të rimbursueshme për “Kurum”-in, “Kurum”-i kërkoi që autoritetet shtetërore të japin disa garanci për të siguruar rimbursimin efektiv të shumës finale të TVSH-së të rimbursueshme e të verifikuar dhe të konfirmuar nga DPT-ja;

g) Autoritetet shtetërore pranuan t’i ofrojnë “Kurum”-it disa garanci për të siguruar rimbursimin efektiv të shumës finale të verifikuar, të tepricës së TVSH-së së rimbursueshme, me kusht që “Kurum”-i të japë, përveç garancive kontraktore sipas MSHA-së të Ulëz-Shkopet, garanci shtesë që MSHA e Ulëz-Shkopet do të realizohet me sukses;

h) “Kurum”-i nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e kreditorit të tepricës së TVSH-së, verifikuar nga DPT-ja si e rimbursueshme, sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pa cenuar të drejtat që i njihen “Kurum”-it për të apeluar sipas ligjit shqiptar, shumata e tepricës së TVSH-së, verifikuar nga DPT-ja si të rimbursueshme, dhe që përbën objekt të kësaj marrëveshjeje, si dhe në cilësinë e ofruesit të garancive shtesë në favor të METE-s, për realizimin e suksesshëm të MSHA-së të Ulëz-Shkopet;

i) DPT-ja nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e organit tatimor kompetent për verifikimin dhe konfirmimin e tepricës së TVSH-së së rimbursueshme për “Kurum”-in, sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar;

j) MF-ja nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e autoritetit kompetent për të autorizuar pagesat nga Buxheti i Shtetit;

k) METE nënshkruan këtë marrëveshje në cilësinë e përfituesit të garancive shtesë nga “Kurum”-i, përveç atyre të dhëna sipas MSHA-së të Ulëz-Shkopet, për realizimin e suksesshëm të MSHA-së të Ulëz-Shkopet.

Rrjedhimisht, për të lehtësuar realizimin e MSHA-së të Ulëz-Shkopet, palët lidhin këtë marrëveshje sipas parashikimeve vijuese:

## 1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

1.1 Objekti i kësaj marrëveshjeje është parashikimi i pagesës së shumave që “Kurum”-i ka të drejtë të marrë nga shteti shqiptar në formën e rimbursimit të gjendjes së tepricës kreditore të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së), të verifikuar sipas ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, pa cenuar të drejtat që i njihen “Kurum”-it për të apeluar sipas ligjit shqiptar, shumat e tepricës së TVSH-së verifikuar nga DPT-ja si të rimbursueshme, dhe që përbën objekt të kësaj marrëveshjeje.

1.2 Objekti i kësaj marrëveshjeje përshin edhe disa procedura në lidhje me instrumentet e garancisë, të rëna dakord mes palëve, sipas të cilave “Kurum”-i garantohet që shuma e tepricës së TVSH-së, verifikuar nga DPT-ja si e rimbursueshme do të paguhet efektivisht në kohë, dhe METE garantohet se “Kurum”-i do të realizojë me sukses MSHA-në e Ulëz-Shkopet.

## 2. HYRJA NË FUQI

2.1 Kjo marrëveshje do të miratohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe do të hyjë në fuqi menjëherë me marrjen nga “Kurum”-i të njoftimit të shkruar të këtij miratimi nga çdonjëri nga autoritetet shtetërore.

## 3. PROCEDURAT E PAGESËS

3.1 DPT-ja dhe “Kurum”-i konfirmojnë vetëm për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, se shuma finale e tepricës së TVSH-së, konfirmuar dhe verifikuar nga DPT-ja si e rimbursueshme në favor të “Kurum”-it, në bazë të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, është 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë), pa cenuar të drejtat që i njihen “Kurum”-it për të apeluar sipas ligjit shqiptar, shumat e tepricës së TVSH-së verifikuar nga DPT-ja si të rimbursueshme, dhe që përbën objekt të kësaj marrëveshjeje.

3.2 MF-ja merr përsipër që brenda 1 (një) dite pune (që do të thotë çdo ditë e javës, përveç ditës së shtunë e të diel dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, që nuk bien në një ditë të shtunë e të diele) nga data e hyrjes në fuqi, do të depozitojë dhe do të ngrijë në një llogari të posaçme garancie, hapur pranë “Raiffeisen Bank Albania”, një shumë të barabartë me vlerën e TVSH-së së rimbursueshme, të verifikuar e konfirmuar si më sipër, prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh) (shuma e TVSH-së). MF-ja do të japë instruksione të parevokueshme që “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë në favor të “Kurum”-it shumën e TVSH-së si më sipër, në përputhje me kushtet dhe afatet e bashkëlidhura si aneksi 1. MF-ja do të instruktojë “Raiffeisen Bank Albania”, që kjo e fundit të lëshojë një konfirmim që ka marrë këto instruksione nga MF-ja për pagesën e shumës së garantuar në lekë si më sipër, konfirmimi, i cili do të jetë kryesisht sipas tekstit të bashkëlidhur si aneksi 2 (deklarata për Kurum-in).

3.3 “Kurum”-i merr përsipër që brenda 1 (një) dite pune (që do të thotë çdo ditë e javës, përveç ditës së shtunë e të diel dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, që nuk bien në një ditë të shtunë e të diele) nga data e hyrjes në fuqi, do të depozitojë dhe do të bllokojë në një llogari të posaçme garancie, hapur pranë “Raiffeisen Bank Albania”, një shumë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh), e cila është e barabartë me vlerën e çmimit të shitblerjes së MSHA-së Ulëz-Shkopet (57.5 euro pesëdhjetë e shtatë pikë pesë milionë) – minus kundërvlerën në euro, sipas kursit ditor të Bankës së Shqipërisë, të shumës së TVSH-së si më sipër në nenin 3.2 (shuma e garancisë). “Kurum”-i do të japë udhëzime të parevokueshme që “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë në favor të METE-s shumën e garancisë si më sipër në euro, në përputhje me kushtet dhe afatet e bashkëngjitura si aneksi 3. “Kurum”-i do të instruktojë “Raiffeisen Bank Albania” që kjo e fundit të lëshojë një konfirmim që ka marrë këto instruksione nga “Kurum”-i për pagesën e shumës së garantuar në euro si më sipër, konfirmimi, i cili do të jetë kryesisht sipas tekstit të bashkëlidhur si aneksi 4 (Deklarata për METE-n).

3.4 Brenda 1 (një) dite pune (që do të thotë çdo ditë e javës, përveç ditës së shtunë e të diel dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, që nuk bien në një ditë të shtunë e të diele) nga data e hyrjes në fuqi, METE, “Kurum”-i dhe MF-ja do të takohen dhe do të shkëmbejnë konfirmimin për “Kurum”-in dhe konfirmimin për METE-n, lëshuar nga “Raiffeisen Bank Albania”, përkatësisht për “Kurum”-in dhe MF-në sipas neneve 3.2 dhe 3.3 më sipër.



#### 4. TË PËRGJITHSHME

##### 4.1 E gjithë marrëveshja

Ky dokument përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve në lidhje me objektin e mësipërm, dhe zëvendësojnë çdo marrëveshje apo mirëkuptim tjetër midis të njëjtave palë, të arritura me gojë apo me shkrim në lidhje me të njëjtin objekt.

##### 4.2 Ndryshimet

Kjo marrëveshje dhe as ndonjë prej parashikimeve të saj, nuk mund të shfuqizohet apo të ndryshohet, nëse nuk shfuqizimi apo ndryshimi nuk kryhet nëpërmjet një marrëveshjeje tjetër të lidhur mes palëve me shkrim.

Termat e përcaktuar në MSHA-në e Ulëz-Shkopet do të përdoren në këtë marrëveshje me të njëjtin kuptim. Palët pranojnë se asgjë në këtë marrëveshje, përfshi anekset e saj, nuk përbën dhe nuk do të konsiderohet si një ndryshim apo amendim i çfarëdolloji, i asnjërit prej kushteve dhe afateve për realizimin e MSHA-së të Ulëz-Shkopet dhe/ose të MSHA-së të Bistricës.

##### 4.3 Gjuha

Kjo marrëveshje lidhet dhe zbatohet në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjes mes versioneve në gjuhë të ndryshme, versioni në gjuhën shqipe mbizotëron ndaj atij në gjuhën angleze.

##### 4.4 Njoftimet

a) Të gjitha njoftimet dhe çdo komunikim tjetër i çfarëdolloj (duke përfshirë, por pa u kufizuar te miratimet, marrëveshjet, kërkesat apo pyetjet), që njëra palë i drejton palës tjetër kryeluanë lidhje me këtë marrëveshje, do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen me postë rekomande apo do të dorëzohen personalisht ose do të dërgohen me faks, te pala marrëse si vijon:

Për MF-në:

Ministrit të Financave

Ministria e Financave, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 (0) \_\_\_\_\_

Për METE-n:

Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 (0) \_\_\_\_\_

Për DPT-në:

Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve

Rr. “Gjin Bue Shpata”, Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 (0) \_\_\_\_\_

Për “Kurum”-in:

Administratorit të “Kurum International” sh.a.

Adresa: Komuna Bradashesh, Kombinati Metalurgjik, Elbasan, Shqipëri

Fax: +35554257844 ose +35542290522

b) Secila prej palëve, me një njoftim të shkruar, mund të ndryshojë adresat, si dhe personin në vëmendjen e të cilit këto njoftime apo komunikime do të dërgohen.

c) Çdo njoftim apo komunikim tjetër, i dërguar nga cilado prej palëve ndaj palës tjetër, që:

i) është dërguar me postë rekomande te marrësi në adresën e përcaktuar, do të prezumohet se është marrë nga marrësi ditën e shtatë pas datës së postimit të saj; ose

ii) është dorëzuar personalisht te marrësi gjatë orarit normal të punës së marrësit në adresën e tij të përcaktuar, do të prezumohet si e marrë nga marrësi në datën e dorëzimit; ose

iii) është transmetuar me faks te marrësi gjatë orarit të tij normal të punës te numri i faksit të përcaktuar, do të prezumohet si i marrë nga marrësi në datën e transmetimit, siç tregohet në raportin e dërgimit të faksit.

#### 4.5 Ligji i zbatueshëm

Kjo marrëveshje do të qeveriset nga dhe do të interpretohet në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

#### 4.6 Juridiksioni

Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje mes palëve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e cila nuk mund të zgjidhet mes tyre me mirëkuptim, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet me arbitrazh sipas nenit 20.2 të MSHA-së Ulëz-Shkopet.

#### 4.7 Kopjet

Kjo marrëveshje lidhet në 4 (katër) kopje, një për secilën palë në gjuhën angleze, dhe secila kopje do të jetë origjinale. Kjo marrëveshje do të përkthehet në shqip.

Në prani të njëra-tjetrës, palët lidhin këtë marrëveshje nëpërmjet nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

Për Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë \_\_\_\_\_  
[Z. Ridvan Bode]

[Ministër i Financave]

Për Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës  
të Republikës së Shqipërisë \_\_\_\_\_

[Z. Florjon Mima]

[Ministër i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës]

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve  
të Republikës së Shqipërisë \_\_\_\_\_

[Z. Gazmir Spahija]

[Drejtor i Përgjithshme i Tatimeve]

Për “Kurum International” sh.a. \_\_\_\_\_

[emri]

[pozicioni]

### SHTOJCA 1 INSTRUKSIONET BANKARE TË MF-së

Në vëmendje të: “Raiffeisen Bank Albania”

Lënda: Instruksione bankare për llogari garancie – me përfitues “Kurum International” sh.a.

Të nderuar zonja/zotërinj,

I/e nënshkruari/a, me tagra të plotë dhe i/e autorizuar për të vepruar në emër dhe për llogari të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet kësaj shkrese instruktoj në mënyrë të “Raiffeisen Bank Albania”, që të mbajë deri në datën 20.5.2013, deri në mbylljen e ditës shumë prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxx, dhe të mos e përdorni këtë shumë për asnjë qëllim, përveçse në përputhje me instruksionet vijuese të pagesës.

Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ju “Raiffeisen Bank Albania” keni marrë nga “Kurum International” sh.a., një kopje të njësuar nga noteri, të deklaratës së përfundimit, nënshkruar mes “Kurum International” sh.a. dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, që konfirmon se transaksioni për shitblerjen e 100% te aksioneve të “HEC Bistrice 1 dhe Bistrice 2” sh.a. është realizuar, atëherë Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë instruktin në mënyrë të përvokueshme “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë në favor të “Kurum International” sh.a., jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e këtij dokumenti, në llogarinë e caktuar nga përfituesi, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë Ministria e Financave, shumë prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh) (shuma e TVSH-së), me përshkrimin rimbursim TVSH-je, pa zbritje apo mbajtje të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguhet nga ne Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.



Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ju “Raiffeisen Bank Albania” nuk keni marrë një kopje të njëzuar nga noteri, të deklaratës së përfundimit si më sipër, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në llogarinë xxxxx do të çlirohet në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej nesh jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit të mësipërm.

Gjithashtu, nëse përpara ose në datën 20.5.2013, ju “Raiffeisen Bank Albania” merrni nga ne Ministria e Financave:

1. një konfirmim të shkruar se shuma totale 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë) i është rimbursuar efektivisht “Kurum International” sh.a. si rimbursim TVSH-je; dhe

2. një kopje të SWIFT-it bankar që konfirmon kryerjen efektive të kësaj pagese në favor të “Kurum International” sh.a.

Atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej nesh jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e konfirmimit dhe dokumenteve si më sipër.

Ju lutemi që të na lëshoni një konfirmim për “Kurum”-in, sipas tekstit bashkëngjitur, në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë i kthejmë “Raiffeisen Bank Albania” këtë kopje origjinale të konfirmimit për “Kurum”-in, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej nesh në Bankën tuaj në llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej nesh, jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënyrën e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe të “Kurum International” sh.a.

Përsëritet,

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë  
Vendi [.....], data [.....]

## SHTOJCA 2 KONFIRMIMI PËR KURUM-in

Në vëmendje të: Kurum International sh.a.

Lënda: Konfirmim bankar për instruksione pagese me përfitues – “Kurum International” sh.a.

Të nderuar zonja/zotërinj,

Ne “Raiffeisen Bank Albania”, ju konfirmojmë se Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë ka depozituar në bankën tonë shumën 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë), dhe se ne “Raiffeisen Bank Albania” kemi marrë instruksionet vijuese të parëvokueshme nga ana e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.

Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ne “Raiffeisen Bank Albania” kemi marrë nga “Kurum International” sh.a., një kopje të njëzuar nga noteri, të deklaratës së përfundimit, nënshkruar mes “Kurum International” sh.a. dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, që konfirmon se transaksioni për shitblerjen e



100% të aksioneve të “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. është realizuar, atëherë ne “Raiffeisen Bank Albania” do të paguajmë në favor të “Kurum International” sh.a., jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e këtij dokumenti, në llogarinë e caktuar nga ju, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë Ministria e Financave, shumë prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh) (shuma e TVSH-së), me përshkrimin rimbursim TVSH-je, pa zbritje apo mbajte të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguhet nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

Nëse deri në datën 20.5.2013 në mbyllje të orarit të punës, në orën 5:00 pm, ne “Raiffeisen Bank Albania” nuk keni marrë një kopje të njësuar nga noteri të deklaratës së përfundimit si më sipër, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë xxxxx, do të çlirohet në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej tyre, jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit të mësipërm.

Gjithashtu, nëse përpara ose në datën 20.5.2013, ne “Raiffeisen Bank Albania” marrim nga Ministria e Financave:

1. një konfirmim të shkruar se shuma totale 3,473,337,091 lekë (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekë) i është rimbursuar efektivisht “Kurum International” sh.a. si rimbursim TVSH-je; dhe

2. një kopje të SWIFT-it bankar që konfirmon kryerjen efektive të kësaj pagese në favor të “Kurum International” sh.a.

Atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej tyre jo më vonë se brenda një dite pune nga marrja e konfirmimit dhe dokumenteve si më sipër.

Ky konfirmim lëshohet në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne “Raiffeisen Bank Albania” marrim nga Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë këtë kopje origjinale të konfirmimit për “Kurum”-in, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së TVSH-së prej 3,473,337,091 lekësh (tre miliardë e katërqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një lekësh), depozituar prej Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në bankën tonë në llogarinë xxxxx do të çlirohet gjithashtu në favor të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e njoftuar prej tyre jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe të “Kurum International” sh.a.

Përsëndetje,

“Raiffeisen Bank Albania”

Vendi [.....], data [.....]



### SHTOJCA 3 INSTRUKSIONET BANKARE TË KURUM-IT

Në vëmendje të: “Raiffeisen Bank Albania”

Lënda: Instruksione bankare për llogari garancie – me përfitues Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë

Të nderuar zonja/zotërinj,

I/e nënshkruari/a, me tagra të plotë dhe i/e autorizuar për të vepruar në emër dhe për llogari të “Kurum International” sh.a., nëpërmjet kësaj shkrese instruktuj në mënyrë të “Raiffeisen Bank Albania”, që të mbajë shumën 32,843,671 euro (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro) depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxxx (llogaria e “Kurum”-it) deri në datën 24.5.2013, deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm dhe të mos e përdorni këtë shumë për asnjë qëllim, përveçse në përputhje me instruksionet vijuese të pagesës.

“Kurum International” sh.a. jep instruksione të parevokueshme që “Raiffeisen Bank Albania” të paguajë automatikisht, jo më vonë se një ditë bankare nga përfundimi i afatit të mësipërm, në favor të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, në llogarinë e caktuar prej tyre, dhe pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë “Kurum International” sh.a., shumën prej 32,843,671 euro (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzetë e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro) (“shuma e garancisë”), pa zbritje apo mbajte të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguhen nga ne “Kurum International” sh.a., nëse deri në datën 24.5.2013 deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, ju “Raiffeisen Bank Albania” nuk merrni nga ne “Kurum International” sh.a.:

1. një shumë depozite shtesë në llogarinë e “Kurum”-it, për një vlerë prej 24,656,329 eurosh (njëzetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e nëntë eurosh) (depozita shtesë), e cila së bashku me shumën e garancisë ekzistuese, do të rrisë balancën totale të llogarisë së “Kurum”-it në shumën totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë eurosh) (depozita totale); së bashku me:

2. një instruksion të parevokueshëm me shkrim nga “Kurum International”, për të transferuar menjëherë nga llogaria e “Kurum”-it, jo më vonë se brenda një dite pune, shumën e depozitës totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë eurosh), në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në llogarinë e caktuar prej tyre, me përshkrim pagesë e plotë e çmimit të shitblerjes për privatizimin e 100% të aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. (pavarësisht këtyre instruksioneve të “Kurum International”).

Nëse ju “Raiffeisen Bank Albania” nuk do të merrni nga ne, brenda datës 24.5.2013 deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, depozitën shtesë, së bashku me instruksionet e shkruara si më sipër, atëherë shuma e garancisë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh) depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxxx, do t’i paguhet menjëherë, jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit 24.5.2013, në favor të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë në llogarinë e caktuar prej tyre, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë “Kurum International” sh.a., me përshkrimin kompensim për mosrealizimin e blerjes së aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet”.

Ju lutemi që të na lëshoni një konfirmim për METE, sipas tekstit bashkëngjitur, në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne “Kurum International” sh.a. i kthejmë “Raiffeisen Bank Albania” këtë kopje origjinale të konfirmimit për METE-n, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së garancisë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro), depozituar prej nesh në bankën tuaj në llogarinë xxxxx, do të çlirohet, gjithashtu, në favor të “Kurum International” sh.a. në llogarinë e njoftuar prej nesh, jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe të “Kurum International” sh.a.

Përschendetje,

“Kurum International” sh.a.

Vendi [.....], data [.....]

#### SHTOJCA 4 KONFIRMIMI PËR METE

Në vëmendje të: Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë  
Lënda: Konfirmim bankar për instruksione pagese me përfitues Ministrinë e Ekonomisë,  
Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë

Të nderuar zonja/zotërinj,

Ne “Raiffeisen Bank Albania”, ju konfirmojmë se “Kurum International” sh.a. ka depozituar në një llogari në bankën tonë (llogaria e “Kurum”-it), shumën 32,843,671 (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro) dhe se ne “Raiffeisen Bank Albania” kemi marrë nga “Kurum International” sh.a. instruksionet vijuese të parevokueshme për të paguar automatikisht, në favor të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, në llogarinë e caktuar prej jush, dhe pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana jonë “Kurum International” sh.a., shumën prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzetë e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh) (shuma e garancisë), pa zbritje apo mbajte të shumave për qëllime të kostove bankare, të cilat do të paguhet nga “Kurum International” sh.a., nëse deri në datën 24.5.2013 deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, e “Raiffeisen Bank Albania” nuk marrim nga “Kurum International” sh.a.:

1. një shumë depozite shtesë në llogarinë e “Kurum”-it, për një vlerë prej 24,656,329 eurosh (njëzetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e nëntë euro) (depozita shtesë), e cila së bashku me shumën e garancisë ekzistuese, do të rrisë balancën totale të llogarisë së “Kurum”-it në shumën totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë euro) (depozita totale); së bashku me:

2. një instruksion të parevokueshëm me shkrim nga “Kurum International”, për të transferuar menjëherë nga llogaria e “Kurum”-it, jo më vonë se brenda një dite pune, shumën e depozitës totale prej 57,500,000 eurosh (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë eurosh), në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në llogarinë e caktuar prej jush, me përshkrim pagesë e plotë e çmimit të shitblerjes për privatizimin e 100% të aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a.

Nëse ne “Raiffeisen Bank Albania” nuk do të marrim nga “Kurum International” sh.a., brenda datës 24.5.2013 deri në mbylljen e orarit të veprimeve bankare, ora 02:30 pm, depozitën shtesë, së bashku me instruksionet e shkruara si më sipër, atëherë shuma e garancisë prej 32,843,671 eurosh (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një eurosh) depozituar në llogarinë e “Kurum”-it, do të paguhet nga ne banka, menjëherë, jo më vonë se brenda një dite pune nga përfundimi i afatit 24.5.2013, në favorin tuaj, Ministria e Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë në llogarinë e caktuar prej jush, me përshkrimin kompensim për mosrealizimin e blerjes së aksioneve të “HEC Ulëz-Shkopet”, pa qenë të nevojshme formalitete të tjera nga ana e “Kurum International” sh.a.

Ky konfirmim lëshohet në 1 (një) kopje origjinale. Nëse ne “Raiffeisen Bank Albania” marrim nga “Kurum International” sh.a. këtë kopje origjinale të konfirmimit për METE-n, brenda 3 (tri) ditësh pune nga data e lëshimit të konfirmimit, atëherë totali i shumës së garantuar 32,843,671 euro (tridhjetë e dy milionë e tetëqind e dyzet e tri mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një euro), depozituar prej “Kurum International” sh.a. në llogarinë xxxxx do të çlirohet gjithashtu në favor të “Kurum International” sh.a. në llogarinë e njoftuar prej tyre, jo më vonë se brenda një dite pune.

Për mënjanimin e çdo dyshimi, këto instruksione pagese mund të ndryshohen ekskluzivisht me nënshkrimin e përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe të “Kurum International” sh.a.



Përsëritje,

“Raiffeisen Bank Albania”

Vendi [.....], data [.....]

**UDHËZIM**  
**Nr. 8/1, datë 17.5.2013**

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008,**  
**“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, pika 2.3.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2.3.1 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit është taksë vjetore për çdo vit kalendarik dhe ka vlefshmëri 365 ditë. Kjo taksë caktohet sipas formulës:

Cilindrata në  $\text{cm}^3$  x koeficienti fikse sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.

Taksa fikse për llojin e karburantit është 12.5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. “Viti i vjetërsisë” është diferenca ndërmjet vitit, kur mjetit i lind detyrimi për të kryer pagesën e taksës me vitin e prodhimit.

P.sh.:

Autovetura

Naftë

Vite vjetërsie/ cilindrata	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1200	2.700	2.850	3.000	3.150	3.300	3.450	3.600	4.200	4.800	5.400	6.000	6.600	7.200	7.800
1300	2.925	3.088	3.250	3.413	3.575	3.738	3.900	4.550	5.200	5.850	6.500	7.150	7.800	8.450
1400	3.150	3.325	3.500	3.675	3.850	4.025	4.200	4.900	5.600	6.300	7.000	7.700	8.400	9.100
1500	3.375	3.563	3.750	3.938	4.125	4.313	4.500	5.250	6.000	6.750	7.500	8.250	9.000	9.750
1600	3.600	3.800	4.000	4.200	4.400	4.600	4.800	5.600	6.400	7.200	8.000	8.800	9.600	10.400
1700	3.825	4.038	4.250	4.463	4.675	4.888	5.100	5.950	6.800	7.650	8.500	9.350	10.200	11.050
1800	4.050	4.275	4.500	4.725	4.950	5.175	5.400	6.300	7.200	8.100	9.000	9.900	10.800	11.700
1900	4.275	4.513	4.750	4.988	5.225	5.463	5.700	6.650	7.600	8.550	9.500	10.450	11.400	12.350
2000	4.500	4.750	5.000	5.250	5.500	5.750	6.000	7.000	8.000	9.000	10.000	11.000	12.000	13.000
2100	4.725	4.988	5.250	5.513	5.775	6.038	6.300	7.350	8.400	9.450	10.500	11.550	12.600	13.650
2200	4.950	5.225	5.500	5.775	6.050	6.325	6.600	7.700	8.800	9.900	11.000	12.100	13.200	14.300
2300	5.175	5.463	5.750	6.038	6.325	6.613	6.900	8.050	9.200	10.350	11.500	12.650	13.800	14.950
2400	5.400	5.700	6.000	6.300	6.600	6.900	7.200	8.400	9.600	10.800	12.000	13.200	14.400	15.600
2500	5.625	5.938	6.250	6.563	6.875	7.188	7.500	8.750	10.000	11.250	12.500	13.750	15.000	16.250
2600	5.850	6.175	6.500	6.825	7.150	7.475	7.800	9.100	10.400	11.700	13.000	14.300	15.600	16.900
2700	6.075	6.413	6.750	7.088	7.425	7.763	8.100	9.450	10.800	12.150	13.500	14.850	16.200	17.550
2800	6.300	6.650	7.000	7.350	7.700	8.050	8.400	9.800	11.200	12.600	14.000	15.400	16.800	18.200

Autovetura  
Benzinë

Vite vjetërsie/ cilindrata	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1200	2.160	2.280	2.400	2.520	2.640	2.760	2.880	3.360	3.840	4.320	4.800	5.280	5.760	6.240
1300	2.340	2.470	2.600	2.730	2.860	2.990	3.120	3.640	4.160	4.680	5.200	5.720	6.240	6.760
1400	2.520	2.660	2.800	2.940	3.080	3.220	3.360	3.920	4.480	5.040	5.600	6.160	6.720	7.280
1500	2.700	2.850	3.000	3.150	3.300	3.450	3.600	4.200	4.800	5.400	6.000	6.600	7.200	7.800
1600	2.880	3.040	3.200	3.360	3.520	3.680	3.840	4.480	5.120	5.760	6.400	7.040	7.680	8.320
1700	3.060	3.230	3.400	3.570	3.740	3.910	4.080	4.760	5.440	6.120	6.800	7.480	8.160	8.840
1800	3.240	3.420	3.600	3.780	3.960	4.140	4.320	5.040	5.760	6.480	7.200	7.920	8.640	9.360
1900	3.420	3.610	3.800	3.990	4.180	4.370	4.560	5.320	6.080	6.840	7.600	8.360	9.120	9.880
2000	3.600	3.800	4.000	4.200	4.400	4.600	4.800	5.600	6.400	7.200	8.000	8.800	9.600	10.400
2100	3.780	3.990	4.200	4.410	4.620	4.830	5.040	5.880	6.720	7.560	8.400	9.240	10.080	10.920
2200	3.960	4.180	4.400	4.620	4.840	5.060	5.280	6.160	7.040	7.920	8.800	9.680	10.560	11.440
2400	4.320	4.560	4.800	5.040	5.280	5.520	5.760	6.720	7.680	8.640	9.600	10.560	11.520	12.480
2500	4.500	4.750	5.000	5.250	5.500	5.750	6.000	7.000	8.000	9.000	10.000	11.000	12.000	13.000
2600	4.680	4.940	5.200	5.460	5.720	5.980	6.240	7.280	8.320	9.360	10.400	11.440	12.480	13.520
2700	4.860	5.130	5.400	5.670	5.940	6.210	6.480	7.560	8.640	9.720	10.800	11.880	12.960	14.040
2800	5.040	5.320	5.600	5.880	6.160	6.440	6.720	7.840	8.960	10.080	11.200	12.320	13.440	14.560

Shënim. Në bazë të shtojcës nr. 1 të ligjit nr. 10 458, datë 29.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, pas vitit të 24-t të përdorimit, për autoveturat, koeficienti rritet me 0.04.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. Vlera e taksës është për vitin kalendarik në të cilin arkëtohet, me vlefshmëri 365 ditë, pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet.

Pagesa e taksës bëhet brenda afatit të vlefshmërisë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25% për çdo vit.

Shembull për llogaritjen e gjobës për mospagesë të taksës brenda afatit të vlefshmërisë së parashikuar:

Mjeti me cilindrata 1900 cm<sup>3</sup>, me naftë dhe vit prodhimi 2001, për vitin 2013 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 15.2.2013, për vlerën 15.200 lekë. Në datën 20.4.2014 pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksën e vitit 2014, pra është me 3 muaj vonesë për pagesën e TVMP-së dhe për këtë arsye duhet të paguajë 15% gjobë, mbi shumën e taksës që duhet të paguajë për vitin 2014 në vlerën 8.550 lekë. Pra, vlera e gjobës është në vlerën 1283 lekë.

Të ardhurat nga taksa dhe gjobat për çdo rast, mbledhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit dhe shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, 5% strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 18% buxhetit të qeverisjes vendore dhe pjesa tjetër Buxhetit të Shtetit.

Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë dhe me pullën e taksës. Zotëuesi i mjetit e vendos pullën e taksës në xhamin e përparmë të mjetit për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit



Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8 pika 3 shkronja “c” të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Dokumentet e mësipërme duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, për të shmangur falsifikimin e tyre.

Drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me organet e tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit janë sipas formularit nr. 2 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Këto drejtori, brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në drejtoritë rajonale të tatimeve dhe në strukturat e Ministrisë së Brendshme listën e mjeteve që nuk kanë paguar taksën për vitin paraardhës, si dhe listën e mjeteve të regjistruara. Personat fizikë apo juridikë, pronarë të këtyre mjeteve, në këto lista do të trajtohen si debitorë dhe nga ana e DPSHTRR-së dhe ndaj tyre do të fillojë të zbatohen masat shtrënguese.

Në rastet e mjeteve, të cilat ndërrojnë pronësinë, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së nuk procedojnë me regjistrimin e pronësisë së mjetit në rast se për atë mjet nuk janë paguar taksat respektive.

Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë taksën vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP) në raport me kohën e hyrjes në qarkullim në territorin e Shqipërisë. Në rast se mjeti regjistrohet në muajin janar, TVMP-ja paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim në raport me muajt e hyrjes në qarkullim, pavarësisht datës së muajit.

Për mjetet që dalin përfundimisht nga qarkullimi, në momentin e paraqitjes së qytetarit për çregjistrimin e përhershëm, llogaritja e vlerës së taksës do të jetë e barabartë në raport me periudhën, që mjeti ka qenë në qarkullim.

Pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 120/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, datë 18.4.2013, të gjithë pronarët e mjeteve që nuk kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura, pavarësisht kur e kanë pasur datën e pagesës së taksës, paguajnë sipas këtij ligji.

Në rast se pronari i mjetit pagesën e taksës vjetore të mjetit të përdorur e bën brenda datës 30 qershor 2013, përveç të drejtës së pagimit të vetëm gjysmës së detyrimit të përlllogaritur para hyrjes në fuqi të ligjit, përjashtohet edhe nga penalitetet për vonesë në pagesën e taksave. Për të gjitha pagesat e vonuara që kryhen pas datës 30 qershor 2013, llogarit penalitet përkatëse. DPSHTRR-ja merr të gjitha masat që të fillojë aplikimin e tyre në sistem nga 1 janari 2014.

P.sh., pronari i një mjeti me cilindratë 1900 cm<sup>3</sup>, me naftë dhe vit prodhimi 2001, për vitin 2013 duhet ta paguante taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 15.2.2013, sipas përlllogaritjeve për vlerën 15.200 lekë:

Rasti a) Nëse paraqitet për pagesë më 20 qershor 2013, paguan 7.600 lekë taksë dhe nuk paguan penalitete.

Rasti b) Nëse paraqitet për pagesë më 1.7.2013, paguan 7.600 lekë taksë dhe i përlllogaritet 25% gjobë mbi shumën e taksës që ka paguar (6 muaj vonesë për pagesën e TVMP-së, por jo më shumë se 25%), pra në vlerën 1.900 lekë.

2. Në pikën 3.1, pas gërmës “d” shtohet germa “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) detyrimet e prapambetura, për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) për qëllime përdorimi apo rishitjeje.

Për këto mjete AAPSK-ja kryen procedurat e nevojshme për rihedhje në qarkullim apo shitje dhe detyrimi për taksën vjetore të mjeteve të përdorura lind në momentin e pajisjes së tyre me lejen e re të qarkullimit, pavarësisht se cili është pronari i tyre.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**

**VENDIM**  
**Nr. 22, datë 20.5.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 26.3.2013 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 3 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Todi Lloshi

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Pirro Çuni

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve nr. 677, datë 5.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 400, datë 23.2.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42/1, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi, në vitin 2004, ka prenotuar një apartament 2+1 në shoqërinë e ndërtimit “Breshani”, duke lidhur, fillimisht, kontratën e shitblerjes nr. 2311 rep. dhe nr. 1157 kol., datë 24.12.2004. Pasi është konstatuar nga palët se numri i apartamentit që ndodhej në katin e 11-të ishte pasqyruar gabim, është lidhur një kontratë tjetër shkëmbimi nr. 187 rep. dhe nr. 177 kol., datë 13.2.2006, e cila nuk është nënshkruar midis kërkuesit dhe firmës së ndërtimit, por midis kësaj të fundit dhe shtetasit P.Ç., i cili është djali i kushëririt të parë të kërkuesit (në vijim “nipi”), që banonte me qira në të njëjtin pallat. Kontrata është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Vlorë, në emër të nipit, i cili është pajisur me certifikatë pronësie nr. 58 pasurie dhe nr. 776 regjistri.

2. Kërkuesi, për shkak të arsyeve shëndetësore, ka vendosur të shesë apartamentin 2+1, por i nipi ka refuzuar t’i japë dokumentet e pronësisë. Për këtë arsye, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt “Begatim pa shkak”, e cila është pranuar me vendimin nr. 1318, datë 13.7.2005, duke detyruar të paditurin (nipin) të paguajë shumat 20 000 USD, 500 000 lekë dhe 13 000 euro, të cilat rezultojnë të jenë këstet e paguara për blerjen e apartamentit. Kundër këtij vendimi i padituri ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 420, datë 7.7.2006, ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit, me arsyetimin se padia duhet të pushohet së gjykuari derisa të zgjidhet çështja penale në ngarkim të të paditurit (nipit), i cili akuzohet për veprën penale të “vjedhjes së pasurisë me anë të mashtrimit”. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 483, datë 18.12.2008, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke i caktuar asaj gjykate detyrën që t’i nënshtrojë hetimit gjyqësor pretendimin në lidhje me njoftimet dhe provat shkresore të paraqitura nga i padituri (kërkuesi). Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. s’ka, datë 5.3.2010, ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit, me arsyetimin se nuk plotësohen kushtet e kërkuara nga neni 655 i Kodit Civil për begatimin pa shkak; se midis palëve ndërgjyqëse po zhvillohet një proces tjetër gjyqësor



me objekt “lirim e dorëzim banese”, për të cilin Gjykata e Apelit Vlorë ka dhënë vendimin nr. 1873, datë 10.7.2008; se palët kanë mundësi të zgjidhin konfliktin me padi të tjera.

3. Në të njëjtën kohë që zhvillohej procesi gjyqësor civil, kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal kundër nipit të tij për veprën penale të mashtrimit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 84, datë 27.3.2007, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit P.Ç. për kryerjen e veprës penale të mashtrimit dhe, në bazë të nenit 143/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 muaj burgim. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 56, datë 21.3.2008, ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se nuk ekzistojnë elementet e veprës penale, por bëhet fjalë për konflikt civil. Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 77, datë 20.2.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokurori dhe kërkuesi.

4. Ndërkohë, në vitin 2008, nipi i kërkuesit (subjekti i interesuar) i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt “lirim dhe dorëzim banese”. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 1873, datë 10.10.2008, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se paditësi nuk legjitimohet në ngritjen e padisë, pasi titulli i pronësisë është fituar mbi bazën e veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme dhe, si i tillë, është *nul*. Po ashtu, gjykata ka urdhëruar çregjistrimin e pasurisë dhe regjistrimin në emër të kërkuesit.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 677, datë 5.7.2010, ka pranuar kërkesëpadinë e nipit të kërkuesit duke vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm, ka pranuar padinë dhe ka detyruar kërkuesin të lirojë dhe t’i dorëzojë nipit banesën sipas certifikatës së pronësisë ZRP Vlorë, zona kadastrale 8602, nr. pasurie 4/63+1-58, volumi 16, f. 118, me sip. 118 m<sup>2</sup>. Gjykata arsyeton se nga tërësia e provave shkresore provohet fitimi primar i pronësisë nga paditësi.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 733, datë 17.8.2010, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të mësipërm.

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për pezullimin e vendimit nr. 1873, datë 10.7.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. 677, datë 5.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, kërkesë, e cila është pranuar nga Kolegji Civil me vendimin nr. 243, datë 10.9.2010.

8. Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 400, datë 23.2.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

## II

9. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 15.8.2012, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pasi procesi gjyqësor i zhvilluar në këto gjykata i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

9.1 Është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, për faktin se kjo gjykatë, në mënyrë të njëanshme, ka marrë të mirëqena pretendimet e pabazuara të nipit të kërkuesit, pa i analizuar ato, por duke i shtrembëruar dhe interpretuar në favor të palës tjetër, ndërkohë që nuk pranoi provat e kërkuesit të pasqyruara në dosje.

9.2 Gjykata e Lartë ka cenuar:

9.2 a) *parimin e paanshmërisë* për faktin se katër nga gjyqtarët në përbërje të Kolegjit Civil që ka vendosur mospranimin e rekursit, kanë marrë pjesë edhe në një proces tjetër gjyqësor, midis të njëjtave palë, duke vendosur prishjen e vendimit nr. 420, datë 7.7.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Po ashtu, njëri prej gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Civil ka marrë pjesë edhe në dhënien e vendimit penal nr. 77, datë 20.2.2009, në dhomë këshillimi, kurse dy gjyqtarë të tjerë në përbërje të Kolegjit Civil kanë qenë pjesë e trupit gjykues që ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1873, datë 10.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndryshuar me vendimin nr. 677, datë 5.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë;

9.2 b) *të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës*, duke vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, ndonëse përmbante shkaqe për t’u kaluar e shqyrtuar në seancë plenare;



9.2 c) *standardin kushtetues për arsyetimin e vendimit gjyqësor*, pasi mungojnë arsyet e mospranimit të rekursit.

10. *Subjekti i interesuar* nuk paraqiti prapësime me shkrim për çështjen objekt gjykimi.

### III

#### *Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese*

11. Gjykata, paraprakisht, thekson se ajo i vlerëson pretendimet e kërkuarit në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor, dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

##### *A. Për pretendimin e cenimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*

12. Kërkuari ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit Vlorë nuk pranoi provat e tij, të cilat ishin të pasqyruara në dosje, por, në mënyrë të njëanshme, ka marrë të mirëqena pretendimet e pabazuara të palës së paditur (nipit), pa i analizuar ato, por duke i shtrembëruar dhe interpretuar në favor të asaj pale.

13. Në jurisprudencën e saj të konsoliduar Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështrim të standardit të mësipërm si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuarit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatës së apelit.

15. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

##### *B. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë*

16. Gjykata konstaton se kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë. Sipas tij, katër nga gjyqtarët, në përbërje të Kolegjit Civil, që ka vendosur mospranimin e rekursit, kanë marrë pjesë edhe në Kolegjin Civil që me vendimin nr. 483, datë 18.12.2008 ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë, me po të njëjtat palë ndërgjyqëse. Po ashtu, kërkuari pretendon se njëri prej gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Civil ka marrë pjesë edhe në Kolegjin Penal që ka dhënë vendimin nr. 77, datë 20.2.2009 (dhomë këshillimi), kurse dy gjyqtarë të tjerë kanë qenë pjesë e Kolegjit Civil që ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1873, datë 10.7.2008.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh, veçanërisht, problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanshmëri të gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 7.3.2011*). Thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i pranisë dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin



gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 29.4.2010*).

18. Në referim të rrethanave konkrete të çështjes, Gjykata konstaton se vendimi nr. 483, datë 18.12.2008 i Gjykatës së Lartë, është marrë në përfundim të procesit gjyqësor me objekt begatimin pa shkak, duke vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke i caktuar asaj gjykate detyrën që t'i nënshtrojë hetimit gjyqësor pretendimin në lidhje me njoftimet dhe provat shkresore të paraqitura nga i padituri (kërkuesi). Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar i takon një procesi gjyqësor të ndryshëm nga ai objekt kundërshtimi në këtë gjykim kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

19. Po ashtu, Gjykata vëren se vendimi gjyqësor nr. 77, datë 20.2.2009, është marrë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori dhe kërkuesi.

20. Gjykata rithekson se Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminatory të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t'ia deformat funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 22, datë 6.6.2011*).

21. Nisur nga karakteristikat e shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë janë të pabazuara.

22. Për sa i përket pretendimit se dy gjyqtarë të tjerë të Kolegjit Civil që ka vendosur mospranimin, në dhomë këshillimi, të rekursit, kanë qenë pjesë e një kolegji tjetër civil që ka marrë në shqyrtim dhe ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1873, datë 10.7.2008, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar.

23. Në vlerësimin e Gjykatës vendimi i pezullimit është një vendim i ndërmjetëm, jopërfundimtar, i cili jepet në fund të një procesi gjyqësor, gjatë të cilit gjyqtarët vlerësojnë: i) pasojat e rënda, nisur nga kushtet subjektive të palëve, kur besohet se ka një disproporcion të madh midis së mirës që synohet të arrihet nga ekzekutimi nga kreditori në raport me dëmin e pësuar nga debitori, dëm, i cili duhet të jetë më i madh se ajo çfarë vetë norma konsideron pasojë të paevitueshme të ekzekutimit të detyrueshëm; ii) pariparueshmërinë e situatës, nisur nga kushte objektive, konkluzion në të cilin arrihet kur dëmi i pariparueshëm rezulton në shkatërrimin e pasurisë që i nënshtrohet ekzekutimit ose humbjen e cilësive të saj thelbësore, duke krijuar një situatë (dëmi), e cila do të jetë e pamundur për t'u kthyer në gjendjen e mëparshme.

24. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se vendimet e pretenduara nga kërkuesi janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

25. Në përfundim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit, për cenimin e parimit të paanshmërisë, është i pabazuar.

**C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor si dhe të të drejtës së ankimit**

26. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 142/1 të Kushtetutës në lidhje me arsytimin e vendimit gjyqësor. Edhe pse kërkuesi parashtronte në rekurs shkelje të

standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa u shprehur për shkaqet konkrete të mospranimit.

27. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Neni 310/1 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e



Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

33. Nga parashikimet e normave të mësipërme procedurale, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij, palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi, por nuk përmban shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se “rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së” duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij.

35. Nga leximi në tërësi i vendimit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve) nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Gjykata vlerëson se pjesët e vendimit nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

36. Gjykata, nisur dhe nga sa u argumentua më lart, çmon gjithashtu se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv si dhe të të drejtës për t’u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

37. Si përfundim, Gjykata vlerëson se vendimi i mospranimit të rekursit, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash:

#### VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës<sup>1</sup>.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 400, datë 23.2.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

<sup>1</sup> Gjyqtarët V.Tusha dhe F.Hoxha votuan për pranimin tërësisht të kërkesës, kurse gjyqtarët V.Kristo dhe A.Xhoxhaj votuan për pranimin pjesërisht të kërkesës, por me arsyetim paralel.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

#### MENDIM PARALEL

Në çështjen në shqyrtim, ndonëse jemi në një mendje me vendimin e shumicës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 400, datë 23.2.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), nuk pajtohemi me arsyet mbi të cilat shumica e mbështet vendimin e saj.

1. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42, 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

2. Gjykata është shprehur se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Siç pranon edhe shumica në vendimin e saj (shih pikat 27, 28, 29), funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke u dhënë njëkohësisht mundësinë ta kundërshtojnë atë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse, **në rastin në fjalë nga kjo Gjykatë (nënvizimi është yni)** dhe, që kjo të bëhet e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe arsyet që e kanë shtyrë për të bërë zgjedhjen ndërmjet disa mundësive. Para së gjithash, ai duhet t'i japë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në proces, pavarësisht se, në kuptimin kushtetues, një përgjigje e detajuar nuk është në çdo rast e domosdoshme.

3. Më tej, Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre, duke qenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës.

4. Shumica, ndonëse me të drejtë i referohet në vendim nenit 310/1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, në vlerësimin e saj bën një shkopje formale jo vetëm të këtyre elementeve përbërëse të një vendimi gjyqësor, por njëkohësisht anashkalon, në mënyrë të njëanshme, jurisprudencën e kësaj Gjykate lidhur me unitetin dhe logjikën e vendimit në të gjitha elementet përbërëse të tij.

5. Konkretisht, shumica e mbështet arsyetimin e saj, për shfuqizimin e vendimit në fjalë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vetëm në konstatimin e faktit se në pjesën hyrëse të tij nuk janë pasqyruar shkaqet për të cilat rekursuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë. Sipas shumicës, një mangësi e tillë krijon dyshime mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv dhe të drejtës për t'u dëgjuar.

6. Megjithëse vendimit të Kolegjit i mungon pjesa arsyetuese, pra vlerësimi i pretendimeve të rekursuesit, qoftë dhe në mënyrë të përmbledhur, dhe qëndrimi që mban ky Kolegj për secilin prej tyre, shumicës i "intereson" vetëm paraqitja formale (ndonëse e nevojshme) e këtyre pretendimeve në pjesën hyrëse të vendimit. Sipas saj (shumicës), pikërisht mospasqyrimi i tyre e bën vendimin të papajtueshëm me Kushtetutën.

7. Në vlerësimin tonë, një qëndrim i tillë, ndonëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë, është skematik dhe i padobishëm, pa vlerësuar atë që është më e rëndësishme në një vendim gjyqësor, pikërisht pjesën arsyetuese e cila lidhet drejtpërdrejt me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Mbi të gjitha, ky qëndrim nuk i shërben aspak kërkuesit i cili pretendimet e tij për proces të parregullt ligjor i lidh me cenimin e të drejtave të tij kushtetuese. Këtu qëndron, në këndvështrimin tonë, karakteri formal i vendimmarrjes së shumicës, e cila, ndonëse nga njëra anë kënaq pretendimin e kërkuesit për shfuqizimin e vendimit në fjalë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nga ana tjetër, dhe që është më e rëndësishme, nuk i jep përgjigje pretendimeve me natyrë ligjore dhe kushtetuese të tij. Pyetja që shtrohet në këtë rast është: A e përmbush standardin e arsyetimit të vendimit një vendim i prishëm i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i plotësuar tashmë, në formë, me parashtrimin e pretendimeve të kërkuesit? Ne mendojmë se jo.



8. Kërkuesi ka pretenduar para Gjykatës së Lartë se Gjykata e Apelit Vlorë ka zhvilluar ndaj tij një proces të parregullt ligjor, sepse ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit. Duke mos marrë përgjigje lidhur me këtë pretendim me natyrë ligjore dhe kushtetuese, kërkuesi e konsideron procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë si të parregullt përderisa edhe vendimi i Kolegjit është i paarsyetuar. Prandaj ai i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ky është shkaku pse ai kërkon shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil si të paarsyetuar dhe deklarimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën. Atij nuk i intereson forma e vendimit të Kolegjit, por përmbajtja e tij, më e pakta, një përgjigje, qoftë edhe skematike, se përse është i pabazuar pretendimi i tij për cenim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Nga ky këndvështrim, mendojmë se arsyetimi mbi të cilin e mbështet shumica vendimmarrjen e saj në këtë çështje, përveçse formale, e bën atë dhe joefektive.

9. Një riformulim i vendimit nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në linjën e kërkuar nga shumica, nuk përmbush pritshmëritë e kërkuesit dhe ai mund t'i drejtohet përsëri Gjykatës Kushtetuese lidhur me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e pretenduara dhe të mbetura pa përgjigje.

10. Përfundimisht, në vlerësimin tonë, fakti që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), në vendimin e tij, nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, sipas të cilit nga Gjykata e Apelit Vlorë është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, përbën cenim të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit. Për rrjedhojë, vendimi, objekt shqyrtimi, duhej shfuqizuar si i papajtueshëm me Kushtetutën për këtë shkak.

Këto janë arsytet për të cilat ndajmë mendim të ndryshëm me vendimmarrjen e shumicës lidhur me arsyetimin e vendimit.

Anëtarë: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

#### MENDIM PAKICE

1. Në çështjen konkrete ndajmë mendim të njëjtë me shumicën në lidhje me mosrespektimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, por vlerësojmë të shprehemi me mendim pakice, pasi çmojmë se kërkesa e kërkuesit duhet të pranohej tërësisht, duke shfuqizuar, për rrjedhojë, edhe vendimin nr. 677, datë 5.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

2. Kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Apelit Vlorë, në mënyrë të njëanshme, nuk ka analizuar asnjë nga pretendimet e tij, por ka marrë të mirëqena pretendimet e subjektit të interesuar (nipit të tij), duke i shtrembëruar faktet dhe duke i interpretuar ato në favor të palës tjetër. Sipas kërkuesit, ky qëndrim i gjykatës ka cenuar barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, si elemente të procesit të rregullt ligjor.

3. Në lidhje me këto pretendime shumica është shprehur se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatës së apelit dhe, për rrjedhojë, i ka vlerësuar si të pabazuara.

4. Ne, gjyqtarët në pakicë, mendojmë se vlerësimi i mësipërm i shumicës është i gabuar, pasi, bazuar në parimin *jura novit curia*, pretendimet e kërkuesit, në rastin konkret, duhen vlerësuar nën dritën e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

5. Nisur nga qëndrimi i konsoliduar i jurisprudencës kushtetuese, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe, për pasojë, nuk mund të zbatohet në praktikë. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari

tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit nr. 677, datë 5.7.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë konstatohet se: i) Vendimi bazohet vetëm në konstatime të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, të fakteve të provuara gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe jo në analizën ose arsyetimin e fakteve dhe provave të pretenduara ose atyre të konstatuara. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë konstaton vetëm se çfarë rezultojnë nga provat (si p.sh. pagesat nga mandat arkëtimet, lidhja e kontratës nga pyetja e dëshmitarëve), por nuk analizojnë asnjë nga provat. Megjithatë, Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se *“e sheh me vend të ndryshojë vendimin e gjykatës dhe të pranojë padinë, pasi nga provat që janë administruar në gjykim ka rezultuar se: ‘paditësi disponon këto prova..., kurse i padituri, gjatë prapësimeve ka paraqitur këto prova...njëkohësisht midis palëve janë zhvilluar edhe disa procese penale dhe civile, duke renditur vetëm vendimet përkatëse”*; ii) Vendimi ndjek logjikën arsyetuese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me faktin se paditësi është pronar dhe e ka fituar pronësinë me kontratë (mënyrë e prejardhur), kurse për sa i përket analizës së legjitimitetit aktiv të paditësit dhe vlefshmërisë ose jo të titullit të pronësisë, Gjykata e Apelit mjaftohet vetëm në renditjen e provave që ka sjellë i padituri, të cilat janë të njëjta me ato të pasqyruara në vendimin e shkallës së parë. ii) Po ashtu, Gjykata e Apelit Vlorë, edhe pse shprehet se paditësi është pronar dhe e ka fituar pronësinë me kontratë (mënyrë e prejardhur), ajo vijon arsyetimin se *“...megjithëse kemi të bëjmë me një provim shumë të vështirë (kur barra i takon atij që e pretendon), vështirësia në procesin e të provuarit hiqet sidomos kur vërtetohet fitimi primar i pronësisë”*.

7. Në vështrim të rrethanave konkrete të çështjes dhe standardit kushtetues për arsyetimin e vendimit, mendojmë se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë ka cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Vendimit objekt kundërshtimi i mungon analiza e fakteve dhe është kontradiktore në konkluzionet në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë. Si rezultat i kësaj kundërshtie të dukshme në arsyetimin e vendimit, mendojmë se argumentet janë të pamjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të vendimit.

8. Pretendimin në lidhje me konkluzionet kontradiktore të Gjykatës së Apelit Vlorë kërkuesi e ka parashtruar edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila rezultojnë se nuk i ka dhënë përgjigje në vendimin e saj nr. 400, datë 23.2.2012, por ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së. Referuar rolit të Gjykatës së Lartë në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe qëndrimin të jurisprudencës kushtetuese në rastet kur vlerësohet se ishte detyrë e Gjykatës së Lartë që të verifikonte dhe shqyrtonte këtë pretendim duke i dhënë një përgjigje të arsyetuar, mendojmë se Gjykata e Lartë duhet të ishte shprehur në lidhje me cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

9. Në respekt të parimit të subsidiaritetit, të ekonomisë gjyqësore dhe të administrimit sa më efektiv dhe praktik të drejtësisë, po ashtu, bazuar në kufijtë e ndryshëm ligjorë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë me atë të Apelit, si dhe nisur nga natyra e rrethanave të çështjes konkrete, mendojmë se shumica duhej të shfuqizonte edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë. Në referim të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, në shqyrtimin në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë. Me kërkesë të palëve ose edhe kryesisht, gjykata e apelit përsërit tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor. Në shqyrtimin gjyqësor mund të lexohen aktet e gjykimit në shkallë të parë dhe, po ashtu, gjykata ka të drejtë të marrë edhe prova të reja. Nisur nga këto kompetenca të Gjykatës së Apelit, vlerësojmë se kjo e fundit e shqyrtonte çështjen duke iu referuar krahas ligjit edhe fakteve konkrete dhe provave.

10. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Po ashtu, Gjykata është shprehur se përbën cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor



rasti kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Në vështrim të sa më sipër, vlerësojmë se shkelja e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë, nuk është plotësuar ose korrigjuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, çmujmë se rivendosja e të drejtave të cenuara të kërkuesit bëhet e mundur përmes kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Vitore Tusha

**VENDIM**  
**Nr. 23, datë 22.5.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 30.4.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 36/26/1/1 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Bajram Himallari

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Këshilli i Ministrave

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 25.8.2010 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kalaja e Dodës, z. Bajram Himallari”.

**BAZA LIGJORE:** Neni 115/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

1. Kërkuesi Bajram Himallari është zgjedhur kryetar i komunës Kalaja e Dodës, qarku Dibër, në zgjedhjet për pushtetin vendor, të zhvilluara në vitin 2007.

2. Në vitin 2010, kërkuesi është vënë në ndjekje penale dhe është akuzuar për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

3. Me vendimin datë 22.8.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar për kërkuesin masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, vendim, i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin datë 13.9.2010, duke caktuar si masë sigurimi personal atë të “detyrimit për paraqitje” në Policinë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



4. Me vendimin nr. 711, datë 25.8.2010, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm, ka vendosur shkarkimin nga detyra, për shkelje të rënda të ligjit, të kryetarit të komunës Kalaja e Dodës, z. Bajram Himallari. Bazuar në nenin 115 të Kushtetutës, kërkuesi Bajram Himallari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 711, datë 25.8.2010.

5. Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.” Gjatë gjykimit të çështjes, Gjykata konstatoi se në lidhje me shkeljet e pretenduara të kryera nga kërkuesi Bajram Himallari, ai është vënë në ndjekje penale nga organi i akuzës për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Për këto arsye, bazuar në nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC), Gjykata vlerësoi se çështja në shqyrtim nuk mund të zgjidhej para se të zgjidhej çështja penale në ngarkim të kërkuesit dhe vendosi pezullimin e shqyrtimit të çështjes në këtë Gjykatë.

6. Për arsye se kjo çështje ka ngelur e pezulluar dhe asnjë nga palët nuk ka kërkuar rifillimin e shqyrtimit të saj, Gjykata, me iniciativën e saj, ka kërkuar informacion lidhur me fazën në të cilën ndodhet gjykimi i çështjes penale në ngarkim të kërkuesit.

7. Pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se, me vendimin nr. 565, datë 12.4.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Bajram Himallari për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të akteve të gjendjes civile”, parashikuar nga neni 191/1 i Kodit Penal.” Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 1069, datë 31.10.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

8. Po ashtu, ka rezultuar se kërkuesi Bajram Himallari ka kandiduar përsëri në zgjedhjet për pushtetin vendor, të zhvilluara në vitin 2011 dhe me vendimin nr. 365, datë 7.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, është vendosur vërtetimi i ligjshëm i mandatit për kryetar të komunës Kalaja e Dodës, lëshuar në emër të tij.

9. Për këto arsye, Gjykata, në bazë të nenit 298, paragrafi i dytë i KPC-së, për shkak se janë zhdukur pengesat që kanë shkaktuar pezullimin, vendosi rifillimin e gjykimit të çështjes dhe caktoi seancën e ardhshme, e cila iu komunikua kërkuesit dhe subjekteve të interesuara, me qëllim të paraqitjes së parashtrimeve përkatëse.

10. Gjykata vëren se kërkuesi është njoftuar rregullisht për riçeljen e seancës plenare, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, por, edhe pse ka marrë dijeni për rifillimin e gjykimit, ai nuk ka paraqitur argumentet dhe qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje. Në kushtet e mësipërme, Gjykata vlerëson se duhet të zbatohen dispozitat e neneve 179/1 dhe 299/c të KPC-së dhe gjykimi i kësaj çështjeje duhet të pushohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenet 179/1 dhe 299/c të KPC-së, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj

Anëtar kundër: Vladimir Kristo



**VENDIM**  
**Nr. 44, datë 30.4.2013**

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “SMOKTHINA” TË SHOQËRISË  
“ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Smokthina”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. për kualifikim të impiantit prodhues për HEC “Smokthina”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 45, datë 30.4.2013**

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HECET: “ARRAS”, “FUNARES”,  
“DUKAGJIN”, “NIKOLICE”, “BULQIZE”, “LURE”, “ORGJOST”, “LEKBIBAJ”, “VELCAN”,  
“ZERQAN”, “BORSH”, “LESHNICE”, “SHOSHAN”, “UJANIK”, “KERPICE”,  
“BARMASH”, “LUNIK”, “HOMESH”, “MUHUR”, “RAJAN”, “MARJAN” DHE “TRESKE 2”  
TË SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SHPK SI BURIME TË RINOVUESHME  
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

në mbledhjen e tij të datës 30.4.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “ARRAS”, “FUNARES”, “DUKAGJIN”, “NIKOLICE”, “BULQIZE”, “LURE”, “ORGJOST”, “LEKBIBAJ”, “VELCAN”, “ZERQAN”, “BORSH”, “LESHNICE”, “SHOSHAN”, “UJANIK”, “KERPICE”, “BARMASH”, “LUNIK”, “HOMESH”, “MUHUR”, “RAJAN”, “MARJAN” dhe “TRESTE 2” si burime të rinovueshme energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k. për kualifikim të impiantit prodhues për hecet: “Arras”, “Funares”, “Dukagjin”, “Nikolice”, “Bulqize”, “Lure”, “Orgjost”, “Lekbibaj”, “Velcan”, “Zerqan”, “Borsh”, “Leshnice”, “Shoshan”, “Ujanik”, “Kerpice”, “Barmash”, “Lunik”, “Homesh”, “Muhur”, “Rajan”, “Marjan” dhe “Treske 2” si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

#### VENDIM

Nr. 46, datë 30.4.2013

### PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “VITHKUQ” TË SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Vithkuq”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 3, germat “a”, “b”, “c”



Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Favina 1 “ sh.p.k. për kualifikim të impiantit prodhues për HEC “Vithkuq”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Sokol Ramadani**

**VENDIM**

**Nr. 47, datë 3.5.2012**

**MBI PROJEKTET PRIORITARE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 14 të rregullores “Për emërimin e administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

pasi konstatoi:

- Statusin juridik të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” të vënë në administrim të përkohshëm sipas nenit 18 pika 4 germa “c” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar;

- Rekomandimin e Avokaturës së Shtetit mbi kompetencat e administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”, dërguar me shkresën nr. 1705/41, datë 8.2.2013;

- Rekomandimet e grupit të punës mbi projektet, që duhet të zbatohen nga ana e shoqërisë “CEZ Shpërndarje”,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projekteve prioritare në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2013, të domosdoshme për operimin e sigurt të rrjetit të shpërndarjes dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve, me vlerë monetare 1.087.892.629 lekë, sipas relacionit të grupit të punës.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 48, datë 3.5.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS-AL” SHPK ME NR. 118,  
SERIE PV11K, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 7,  
DATË 2.2.2011**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energy Partners-AL” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 118, seria PV11K “Për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike”, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 7, datë 2.2.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Energy Partners-AL” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë “Energy Partners-AL” sh.p.k. me nr. 118, seria PV11K “Për prodhimin e energjisë elektrike”, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2011.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**



**VENDIM**  
**Nr. 49, datë 3.5.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “MAKSI ELEKTRIK” SHPK ME NR. 30, SERIE PV06P, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 1, DATË 11.1.2006**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 30, seria PV06P “Për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike”, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 1, datë 11.1.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë “Maksi Elektrik” me nr. 30, seria PV06P “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga hecet “Leskovik” me fuqi 72 KW dhe “Leskovik 2” me fuqi 100 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 11.1.2006.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 50, datë 3.5.2013**

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “EN.KU” SHPK ME NR. 10, SERIA PV03P, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 20, DATË 19.1.2003, MODIFIKUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 86, DATË 17.7.2008**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3 pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “EN.KU” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 10, seria PV03P “Për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike”, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 20, datë 19.1.2003, modifikuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “EN.KU” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “EN.KU” me nr. 10, seria PV03P “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga HEC “Bicaj” me fuqi 100 KW, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 20, datë 19.1.2003, modifikuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008.

2. Fuqia e instaluar e HEC “Bicaj” nga 100 KW të bëhet 3.1 MW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**



**VENDIM**  
**Nr. 51, datë 3.5.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit”, nenit 15 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë, sh.a. për modifikim të licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë HEC Lanabregas sh.a., dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “HEC-Lanabregas” sh.a. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë “HEC Lanabregas” sh.a.
  2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 52, datë 3.5.2013**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TUCEP” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TUCEP”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 100 e në vazhdim të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 4 pika 1 germa “a”, nenit 5 pika 1 germa “a”, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të



Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Tucep” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Tucep” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Tucep” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tucep”, për një afat 30-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

#### VENDIM Nr. 53, datë 3.5.2013

### **PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “EMIKEL 2003” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3 pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Ankesa e paraqitur nga subjekti “Emikel 2003” sh.p.k., është brenda afateve ligjore të vendosura nga ERE (afate të përcaktuara në nenin 16, pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, gjithashtu, të përcaktuar dhe në nenin 10 pika 11 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”).
- Aktiviteti i prodhimit të energjisë elektrike, procedurë, e cila ndiqet nga ERE, detyrimisht lidhet me pasjen në pronësi të aseteve hec (të cilat janë objekt gjykimi në çështjen civile mes palëve).
- Akti administrativ i licencimit në aktivitetin e prodhimit të energjie elektrike, është një akt administrativ, që ka pasoja të drejtpërdrejta mbi asetin përkatës (konkretisht HEC “Tucep”).



- Shoqëria “Emikel 2003” sh.p.k. në marrëveshjen e shtesës së koncesionit e lidhur me METE- në datën 3 prill 2013, ka hequr dorë nga çdo e drejtë dhe detyrim mbi HEC “Tucep”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “Emikel 2003” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga hecet “Lenie”, “Çorovodë” dhe “Tucep”.

2. Në gjithë tekstin e licencës së shoqërisë “Emikel 2003” sh.p.k. hiqet fjala “Hec Tucep” me kapacitet 0.4 MW, kudo ku është shkruar.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**

**Nr. 54, datë 3.5.2013**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMIT NR. 161, DATË 7.12.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 8 pika “b” dhe “ç” nenit 9 dhe nenit 26 ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

- Ekzistojnë paqartësi dhe pasiguri të treguesve kryesorë të llogaritjes së tarifës së energjisë elektrike për të gjitha aktivitetet e rregulluara;

- Shoqëria “CEZ Shpërndarje” operon me statusin në administrim të përkohshëm, situatë, e cila e bën të pamundur vendosjen e objektivave për treguesit e performancës;

- Aktualisht ERE me vendimet e datës 7.12.2011 ka aprovuar një tarifë mesatare trevjeçare për periudhën 2012-2014 për të gjitha aktivitetet e rregulluara, bazuar në mesataren e të ardhurave të kërkuara për të tria vitet;

Si dhe referuar situatës aktuale në sektorin e energjisë elektrike, e cila është e ngjashme për nga pamundësia e vendosjes së objektivave me situatën e vitit 2009, vit kur u mbyll procesi i privatizimit të 76% të aksioneve të kompanisë së shpërndarjes dhe ku ERE shtyu afatin e zbatimit të tarifave të vitit 2008 përgjatë vitit 2009 (vendimi nr. 7, datë 26 janar 2009).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të vendimit nr. 161, datë 7.12.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, deri në datën 31 dhjetor 2013.

2. Përditësimin dhe kompensimin e të gjitha efekteve të mundshme financiare në vitin pasardhës brenda së njëjtës periudhë rregullatore 2012-2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 27.5.2013  
Doli nga shtypi më 27.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë